



Teknika dhe strategji për menaxhimin e fëmijëve me vështirësi në të nxënë dhe me ADHD në klasë



Akademia Shëndet, Psikologji dhe Komunitet

1. Synimet e kursit

Nga vlerësimi dhe diskutimi i profesionistëve të fushës doli në pah nevoja që ata kanë për një trajnim më të thelluar teorik dhe praktik mbi njohjes e teknikave bazë të menaxhimit të klasës, llojet e teknikave të ndryshme, gjetja e pikave të forta në ato fusha për të përmirësuar performancën e tyre dhe për të siguruar që ata të ofrojnë shërbim cilësor, rëndësinë mbi partneritetin me prindërit. Nga të dhënat e mbledhura del në pah nevoja për:

Njohje mbi rëndësinë e menaxhimit të klasës

Komponentët kryesorë në mënyrën e organizimit të klasës

Bashkëpunimi me ekipin multidisiplinar

Teknikat dhe strategjitë për menaxhimin e fëmijëve me vështirësi në të nxënë dhe me ADHD në klasë

Faktorët ndikues për një bashkëpunim sa më produktiv

Si të ndryshojmë dhe të menaxhojmë nëpërmjet identifikimit të teknikave të duhura një klasë gjithëpërfshirëse

2. Kush ka të drejtë të aplikojë

Pjesëmarrës në këtë trajnim mund të jenë:

Psikologë të cilët punojnë në kontekste dhe institucione të ndryshme arsimore.

3. Kohëzgjatja dhe mënyra e zhvillimit

Është një trajnim afatshkurtër një ditor për infermierët që duan të aftësohen edhe më shumë në profesionin e tyre.

Trajnimi zhvillohet në 1 ditë

Data 18/03/2023

Orari: 09⁰⁰-14⁰⁰



4. Përmbajtja e programit të trajnimit

Trajnimi është i organizuar në leksione interaktive, diskutime në grup dhe praktikë. Me një kombinim të të tre metodave arrihet në një përvetësim më të mirë të teknikave nga profesionistët.

5. Organizimi i trajnimit

Trajnimi është një trajnim dinamik profesional i cili ka 5 kredite dhe është i akredituar nga Urdhri i Psikologut. Trajnimi organizohet në 1 ditë pranë Universitetit Barleti dhe frekuentimi i trajnimit është i detyrueshëm gjatë gjithë kohëzgjatjes së tij qoftë në pjesën praktike, qoftë dhe atë teorike.

6. Vendi i zhvillimit të trajnimit

Trajnimi do të zhvillohet fizikisht në Universitetin Barleti. Veprimtaria mësimore përfshin leksione interaktive dhe prezantime nga trajnuesja, diskutime në grup dhe demonstrimi në praktikë i të gjitha teknikave të përfshira.

7. Mundësitë e punësimit dhe karriera

Certifikata e këtij kursi të formimit të vazhduar ndihmon në rritjen profesionale të pjesëmarrësve duke i ofruar atyre njohuri dhe teknika të intervistave me fëmijët si pjesë e vlerësimit të shëndetit mendor të tyre, si dhe pajisjen me kreditet përkatëse në kuadër të procesit të licencimit apo rilicencimit nga Urdhri i Psikologut.

8. Certifikimi

Trajnimi është i akredituar nga Urdhri i Psikologut.

9. Garancia e programit të trajnimit

Universiteti Barleti, nëpërmjet strukturave në varësi ka përgjegjësitë e mëposhtme:

- Të zbatojë të gjitha kriteret profesionale dhe pedagogjike për realizimin e leksioneve, diskutimit në grup dhe praktikave gjatë trajnimit.
- Të mbështesë pjesëmarrësit në plotësimin e kërkesave që lidhen me zbatimin e programit të trajnimit.
- Të krijojë kushtet e përshtatshme për realizimin e programit (të sigurojë mjediset, rrjetin e informacionit, të vendosë në dsipozicion mjetet mësimore dhe teknologjinë elektronike).
- Të sigurojë zgjidhje të problematikave lidhur me pjesëmarrësit mbi ecurinë në kurs, prezencën, dërgim materialesh, leksionesh, etj.